

Rezymeja për temën e Masterit

ARKIVAT DHE BURIMET GOJORE

KAQUSHA PRENKU

Prof. Dr. Bujar Dugolli

Historia gojore i referohet studimit të së kaluarës përmes historive jetësore e rrëfimeve personale, ku informatorët apo rrëfimtaret flasin për përvojat e veta. Ata shpjegojnë një moment historik sipas perspektivës personale, sipas përvojës që e kanë kaluar vetë në atë moment historik. Historia gojore sajohet prej kujtimeve të treguara dhe të bartura gojarisht. Përfshin dëshmi të dëshmitarëve okularë dhe të informuar për ngjarje historike në kohë dhe hapsirë të caktuar.

Historia gojore paraqet “vetëm një prej mjeteve të cilat iu ndihmojnë njerëzve që në mes vete të komunikojnë”. Kjo metodë jep dimensionin plotësues të hulumtimeve historike në kuptimin shkencor me rrugën që nëpërmjet të saj të njihen detajet për mënyrën e jetës gjatë periudhës së caktuar historike, për të cilën pak dihet, që me ndihmën e historisë gojore mund të zbuten paragjykimet për personat e caktuar, grupet dhe ngjarjet, mund të ruhen aspektet e rëndësishme të përvojave njerëzore, sepse në të kundërtën do të humbnin dhe harroheshin.

Arkivat janë institucione në të cilat ruhet thesari burimor i shkruar – dokumentet dhe shënimet të cilat flasin nga dora e parë. Aty janë shënime të cilët drejtpërdrejt janë të lidhura me ngjarjet për të cilat kanë të bëjnë, më së shpeshti të krijuara nga ato dhe për ato, por jo edhe si vështrim plotësues dhe shpjegim i ngjarjeve të kaluara. Për këtë arsye shënimet burimore arkivore kanë vlerë të veçantë si gjurmë autentike dhe të besueshme të së kaluarës dhe ngjarjeve të cilat i dokumentojnë.

Lënda arkivore është ruajtur dhe ruhet me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave personale dhe kolektive, të cilat janë dëshmuar dhe janë realizuar në bazë të dokumenteve autentike. Prandaj, kjo i obligon të gjithë subjektet që t'i kushtojnë kujdes të posaçëm mbrojtjes dhe ruajtjes së saj në institucionet arkivore, të fondkrijuesit dhe poseduesit e ndryshëm dhe të kujdesen për arkivat. Lënda arkivore përman bazën themelore dhe pjesën të patjetërsueshme të thesarit kulturor. Ajo ruan kujtesën e popujve dhe nga ajo në masë të madhe varet edhe ekzistenca e kujtesës së tërësishme të bashkësisë njerëzore.

Në kapitullin e I, kam trajtuar temat dhe çështjet që kanë të bëjnë me këto objektiva si; Zhvillimi historik i Arkivistikës dhe Arkivave, Ndarjen e Arkivistikës, Marrëdhënjet e Arkivistikës me disiplinat tjera, Llojet e Arkivave dhe Roli i tyre.

Zhvillimi i arkivave ka shkuar nëpër faza të shumta që kanë arritur deri në ditët e sotme nga dokumentet tradicionale në letër e deri të dokumentet elektronike.

Në këtë kapitull, kam trajtuar edhe marrëdhëniet e Arkivistikës me disiplinat e tjera dhe lidhjen e ngushtë me këto disiplina:

- Historia: Me histori mund të kuptohet pikërisht:

a) *Në kuptimin objektiv të fjalës*: ngjarja, zhvillimi, ndodhitë në vetvete.

b. Në kuptimin subjektiv të fjalës: perceptimi, vëzhgimi, vlerësimi dhe interpretimi, me ndodhitë e përmendura prej njerëzve dëshmojnë “vetëdijen historike” dhe kështu sqarohet ndodhia, pra historia. Ndërsa disiplinat tjera janë: - Paleografia: - Diplomatika: - Sfragistika: - Kronologjia: - Numizmatika: - Arkeografia: - Gjenealogjia: - Heraldika: - Heuristika: - Epigrafia: - Filigranologjia: - Filmologjia: - Ideografia: - Ikonografia: - Kriptologjia: - Kimia: - Informatika.

Në këtë kapitull, kam trajtuar gjithashtu edhe ndarjen e Arkivave, në bazë të rregullimit shoqëroro-politik, ndarjes administrativo-territoriale dhe të tjera është organizuar rrjeti arkivor i një vendi.

Në botë ekzistojnë këto lloje, përkatësisht tipe të arkivave:

- Arkiv i Përgjithshëm: - Arkiv Kombëtar: - Arkiv Amë: - Arkiv Historik: - Arkiv Rajonal: - Arkiv Ndërkomunal: - Arkiv Komunal:- Arkivi i Qytetit: - Arkiv Special: - Arkiv Diplomatik: - Arkiv Ekonomik: - Arkivi i Kino-foto-fonotekës: 1- Arkiv Hartografik: - Arkiv Privat: - Arkiv Kishtar: - Arkiv Familjar: - Arkiv i Shkrimtorës:

Në këtë kapitull, kam trajtuar gjithashtu edhe Kuptimin, rolin dhe veprimtarinë e arkivave, Arkivat përbëjnë kujtesën e kombeve dhe të shoqërive. Ato përbëjnë bazën e identitetit të tyre dhe janë një element thelbësor i shoqërisë së informimit.

Në kapitullin e II, kam trajtuar temat dhe çështjet që kanë të bëjnë me këtë objektiva si; Krijimi I lëndës arkivore, ku përfshihet kjo renditje; *Lënda arkivore, Materiali regjistror, Lënda arkivore publike, Lënda arkivore private, Lëndë e trashëguar, Lëndë e shtypur, Lënda filmike, Lënda memoare, Lënda operative, Dokumenti – shënimi (record), Lënda elektronike (electronic file) –*

Në kapitullin e II, gjithashtu trajtoj edhe për Burimet historike – arkivore, ku përgjithësisht, pa marrë në konsideratë qëllimin e prodhuesit, mund të bëhet dallimi në mes të këtyre tipeve të burimeve:

- Burime materiale: vendvarrimet, kolonitë, ngulimet, ndërtesat, tekstilet, veshjet, instrumentet;

- Burimet figurative: monumentet e artit vizual, vizatimet tekniko-shkencore, vizatimet për publikime, harta, shenjat: shenjat fetare, shenjat magjike, shenjat teknike, shenjat politike, veshjet e ushtrive, vulat, shenjat dalluese, fotografitë;

- Burimet gjuhësore:

- *gjuha në vetvete;*

- *burimet gojore të trashëguara:* emrat, përrallat me zana, mitet, legjendat; këngët popullore; tregimet, gjë a gjëzat, lojërat gazmore, rimat e ndryshme (bejtet);

- *burimet e shkruara tradicionale:* shkrimet dhe stilet e shkrimit me dorë; burimet historiografike; burimet letraro-poetike; biografitë; burimet e shkruara administrative (diplomat, regjistrat e dokumenteve publike, burimet legale); indekset personale; indekset e objekteve – inventarët; raportet, shënimet, materialet ndihmëse referuese; dokumente, dorëshkrime në përgjithësi; burimet e botuara të propagandës; shënimet dhe publikimet në aktivitete shkencore në një kuptim më të gjerë; mbishkrimet;

- Burimet audio-vizuale;

- Burimet kompjuterike.

Në këtë kapitull kam trajtuar edhe një çështje shumë me interes, siq është, Mbrojtja e lëndës arkivore. Ne e dimë që Lënda arkivore është e mbrojtur me ligj, pa marrë parasysh pronë e kujt është dhe ku gjendet. Mbrojtja e lëndës arkivore realizohet përmes evidentimit, grumbullimit, rregullimit, klasifikimit, mirëmbajtjes, mikrofilmimit, digjitalizimit, përpunimit, restaurimit dhe sigurimit nga dëmtimi, shkatërrimi dhe humbja. Lënda arkivore ka tretman të posaçëm shoqëror, ruhet përgjithmonë, është pronë shtetërore, ruhet në tërësi dhe nuk mund të tjetërsohet. Mbrojtja e lëndës arkivore krijohet në parimin “ex Lege”, në përgjithësi, çka nuk është rasti për llojet e tjera të monumenteve kulturore, të cilat karakterizohen kryesisht me procedurë të veçantë.

Në këtë kapitull, kam trajtuar me një pjesë të veçantë edhe Obligimet e arkivave, ku mund të themi, se në bazë të dispozitave ligjore vendore, akteve ndërkombëtare, obligimeve tjera që dalin nga aktet normative dhe detyrat e kompetencave ligjore të tija, arkivi është i obliguar që:

- të zbatoj masat mbrojtëse të lëndës arkivore dhe të kujdeset për sigurimin e saj;
- e rregullon, regjistron dhe publikon lëndë arkivore, si dhe e

jep në shfrytëzim;

- bën mbikëqyrjen profesionale në ruajtjen dhe përzgjedhjen e lëndës arkivore, e cila gjendet jashtë arkivit dhe i cakton masat e ruajtjes së saj;

- bën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë në punën e arkivave dhe poseduesve të tjerë të lëndës arkivore;

- pranon lëndën arkivore publike;

- grumbullon lëndën arkivore private përmes blerjes, faljes

ose depozitit;

- bën mikrofilmimin e lëndës arkivore me qëllim të sigurimit dhe të mbrojtjes;

- kryen punët e restaurimit dhe të konservimit lidhur me lëndën arkivore;

- jep shënime, lëshon dëshmi nga dokumentet si kopje të

vërtetuara me kërkesë të shfrytëzuesve;

- përpilon dhe publikon mjete ndihmëse informative për fonde dhe koleksione të caktuara;

- ushtron punë profesionale, shkencore nga arkivistika

nëpërmjet studimeve, programeve dhe projekteve për zhvillimin dhe përparimin e shërbimit arkivor;

- organizon ligjërata, kurse dhe forma të tjera të aftësisimit dhe perfeksionimit profesional të kuadrit arkivor;

- organizon ekspozita, ligjërata dhe kryen veprimtari tjera

kulturore, me qëllim të afirmimit, interesimit etj. për lëndën arkivore dhe shërbimin arkivor;

- bashkëpunon reciprokisht edhe me organizatat tjera të kulturës, shkencës dhe institucioneve të afërta të shërbimeve të dokumentacionit dhe të informatikës me qëllim të

përparimit të veprimtarisë arkivore dhe punës shkencore në lëmin e arkivistikës, shkencave informatike, shkencave ndihmëse të historisë dhe të tjera.

Në kapitullin e II, Mbrojtja teknike e lëndës arkivore, ku I kemi cekur disa faktor të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e lëndës arkivore. Ata janë faktorët e jashtëm dhe faktorët e brendshëm.

Faktorët e jashtëm rrjedhin nga kushtet e vendosjes së lëndës në depo dhe kryesisht janë: fiziko-kimik – lagështia, temperatura, rrezet e diellit, pluhuri, ndotja e ajrit etj.; biologjik – myku i bardhë, bakteret, insektet, brejtësit; mekanik - ndrydhja dhe thyerja e dokumenteve për shkak të pakujdesisë, ose mjetet e papërshtatshme ku janë vendosur dokumentet (fashikujt, kutitë, mapat, albumet etj.). Këtu bëjnë pjesë edhe fatkeqësitë elementare – zjarret, vërshimet, tërmetet dhe rrënimet nga luftërat.

Faktorët e brendshëm, të cilët kontribuojnë në dëmtimin dhe shkatërrimin e lëndës arkivore rrjedhin nga llojet e ndryshme të dokumenteve dhe materialeve me të cilat është shkruar. Kjo ka të bëjë më tepër me përbërjen kimike të letrës, përkatësisht acidit që përbën ajo.

Kur dihen të gjithë shkaktarët të cilët ndikojnë në dëmtimin e lëndës arkivore, atëherë është e domosdoshme që të merren masat e nevojshme të mbrojtjes teknike.

Në këtë kapitull, kam trajtuar edhe Shfrytëzimin e lëndës arkivore, ku kam folur për Rolin dhe rëndësia e dokumentit arkivor si dëshmi e fakteve historike, juridike dhe fakteve të tjera relevante jetësore, e ngrit gjithnjë e më tepër vlerën e tij për nevoja shkencore e shoqërore. Paralelisht me zhvillimin e historisë si dhe metodave hulumtuese të saj, ngritet rëndësia e lëndës arkivore si burim i hulumtuesve, duke ia dhënë karakteristikat e rolit bashkëkohor, dhe me këtë edhe të arkivave. Kërkesat e zhvillimit shoqëror kanë bërë që përveç rëndësisë shkencore, lënda arkivore si monument i kulturës, të ketë edhe rëndësi kulturore-arsimore, propagandistike etj.

Kurse sa i përket **kapitujve III dhe IV**, jam fokusuar kryesisht në hulumtimet e burimeve që kanë të bëjnë me historinë gojore, ku kam analizuar dhe kam trajtuar temat dhe çështjet që kanë të bëjnë dhe lidhen me temën time, që ka qenë e koncentruar pikrisht në këto çështje dhe burime.

Po ashtu, dëshiroj të theksoj se në kapitullin e III, vlenë të veçohen këto objektiva: Rëndësia e ditarëve dhe odave si burim plotësues në ndriqimin e ngjarjeve historike, Roli dhe rëndësia e historisë gojore, Të dhënat historike të shkruara dhe ato gojore, Metodologjia hulumtuese e historisë gojore, Kuptimi i intervistës, Teknologjia e re dhe të dhënat gojore.

Kurse kapitulli IV, trajton këto objektiva: Intervista me anë të internetit, Interpretimi I historisë gojore, Pranimi i burimeve gojore në arkiv, Mbrojtja dhe ruajtja e dëshmive gojore, Shfrytëzimi i të dhënave gojore në arkiv.

Me respekt,

Kaqusha Prenku

Prishtinë, maj 2021